

Gjuha e lehtë

Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës 2025

Udhëzime



09
Shkurt
2025
Voto v

Çfarë janë zgjedhjet e përgjithshme?

Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës do të mbahen të dielën më datë **09.02.2025**.

Ju do të votoni personat që dëshironi të udhëheqin Kosovën.



Zgjedhjet në Republikën e Kosovës

Partia politike që fiton në zgjedhjet e përgjithshme të Kuvendit të Kosovës e udhëheq **qeverinë për 4 vite**.



Kryeministri është kandidati i përzgjedhur i partisë politike i cili udhëheq Qeverinë e Kosovës.



Pse vota ime është e rëndësishme?

Është mundësia juaj që të përzgjidhni se kush janë njerëzit më të mirë për të vendosur për Kosovën.

Nga këto zgjedhje merren vendimet për ligjet, taksat, përfitimet tuaja e gjykata.

Ju do të zgjidhni se kush do të flet për juve dhe të drejtat tuaja.

Qendra e Votimit

Qendra e votimit është vendi ku ju shkoni për të votuar për zgjedhje.

Ju duhet të shikoni se ku e keni qendrën e votimit duke u orientuar në ueb faqen kryesore të KQZ në këtë link <http://qv.kqz-ks.org>

Në këtë link duhet të shënoni numrin personal dhe datë e lindjes dhe pas kësaj do të shfaqet qendra e votimit të tuaj.

Mënyra e votimit fizik

Qendrat e votimit hapen në orën 07:00 dhe mbyllen në orën 19:00 të dielën më datë 09.02.2025



Shkoni në qendrën e votimit për të votuar brenda kësaj periudhe kohore në qendrën tuaj të votimit.



KQZ

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Në dyert e qendrave të votimit janë të shënuara shkronjat e para të mbiemrit. Ju do të gjeni shkronjën e parë të mbiemrit tuaj.

Merrni me vete letërnjoftimin tuaj.



Kur të arrini aty stafi do t'ju kërkojë emrin, mbiemrin dhe letërnjoftimin për të vërtetuar nëse jeni të regjistruar në qendër të votimit dhe më pas do të nënshkruheni.

ZGJIDHET PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2023
IZBORI ZA DEPUTETE REPUBLIKE KOSOVE 2023

1	2	3	4	5			
<input type="checkbox"/>	111	INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	1	2	3	4	5
<input type="checkbox"/>	112	SIRPSKA LISTA	6	7	8	9	10
<input type="checkbox"/>	113	Jedinstvena Goranska Partija	11	12	13	14	15
<input type="checkbox"/>	114	PARTIA ROMË E BASHKUJËR E KOSOVËS	16	17	18	19	20
<input type="checkbox"/>	115	PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE-PLË	21	22	23	24	25
<input type="checkbox"/>	116	SIRPSKA DEMOKRATIA	26	27	28	29	30
<input type="checkbox"/>	117	Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar	31	32	33	34	35
<input type="checkbox"/>	118	Livija VETËVENDOSJE!	36	37	38	39	40
<input type="checkbox"/>	119	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	41	42	43	44	45
<input type="checkbox"/>	120	Partija kosovërisë Shtë	46	47	48	49	50
<input type="checkbox"/>	121	Neta Bologjicka Koalicija (Neta koalicioni / Bologjicka stranka)	51	52	53	54	55
<input type="checkbox"/>	122	Kosova Adalat Türk Partisi	56	57	58	59	60
<input type="checkbox"/>	123	PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	61	62	63	64	65
<input type="checkbox"/>	124	LEHUA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	66	67	68	69	70
<input type="checkbox"/>	125	PDAA-LPS	71	72	73	74	75
<input type="checkbox"/>	126	GRADJANSKA INICIATIVA NARODNA PRAVDA	76	77	78	79	80
<input type="checkbox"/>	127	SOCIALDEMOKRATSKA UNIJA - SDU	81	82	83	84	85
<input type="checkbox"/>	128	Faktor Blytyri	86	87	88	89	90
<input type="checkbox"/>	129	Koalicioni për Familje	91	92	93	94	95
<input type="checkbox"/>	130	Venikçi Turk Halklar Partisi	96	97	98	99	100
<input type="checkbox"/>	131	PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	101	102	103	104	105
<input type="checkbox"/>	132	Za Slobodu Pravdu i Opatanak	106	107	108	109	110
<input type="checkbox"/>	133	Brigadi narodni pukari					
<input type="checkbox"/>	134	KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI					
<input type="checkbox"/>	135	Koalicija Vakat					
<input type="checkbox"/>	136	Opna Roma Kosova					
<input type="checkbox"/>	137	AAK - ALIENCA PËR ARDHËMERINË E KOSOVËS NEMA - Nama Socialdemokrat, Konservator, Intelektualit					
<input type="checkbox"/>	138	FJALJA					

Stafi do t'ju jep fletëvotimin dhe ju orienton në kabinën e votimit.

1. Në anën e majtë të fletëvotimit janë të renditura subjektet politike.

2. Zgjidhni vetëm një subjekt politik.

Shenjzoni me tik subjektin tuaj që doni të përzgjidhni.



3. Në anën e djathtë, mund të votoni deri në dhjetë kandidatë duke shenjzuar me tik **v** 10 numrat e kandidatëve për deputetë.

4. Pasi të plotësoni fletëvotimin: Paloseni fletëvotimin, vendoseni brenda zarfit dhe mbylleni zarfin.

5. Mos shkruani asgjë mbi zarf!



Pasi të votoni, i mbyllni letrat tri herë dhe më pas i futni në kutitë e votimit.

Nëse keni nevojë për ndihmë kërkoni nga stafi i qendrës së votimit.

